



INFORMACION FILLESTAR

Të nderuar klientë,

Këtu ju gjeni një informacion të shkurtër mbi temat më të rëndësishme gjatë periudhës së papunesise suaj. Qëllimi ynë është që ju të gjeni sa më shpejt punën e duhur!

Takime këshillimi



Takimet për këshillim bëhen personalisht ose përmes telefonit.

Gjatë takimit diskutojmë:

- Situatën tuaj profesionale, përvojën dhe aftësitë tuaja
- Kushtet tuaja personale
- Aktivitetet e planifikuara të aplikimit për punë
- Pritshmëritë tuaja nga këshillimi
- Afatet dhe takimet

Ju lutemi të mendoni paraprakisht në cilin sektor dëshironi të punoni. Ne së bashku do të kërkojmë punë të përshtatshme për ju!

Në përgjithësi, të gjitha takimet janë të detyrueshme!

Nëse nuk mund të merrni pjesë, ju lutemi na informoni me kohë!

Marrëveshja e Mbikëqyrjes/kujdesit



Të gjitha marrëveshjet nga takimet e këshillimit dokumentohen në Marrëveshjen e Mbikëqyrjes.

Ju do ta merrni këtë marrëveshje nga këshilltari apo këshilltarja juaj e AMS-it dhe këtë mund ta shikoni edhe në llogarinë tuaj MeinAMS.

Përfitime financiare



Dorëzoni një kërkesë për përfitime inanciare më së miri përmes llogarisë suaj MeinAMS ose paraqituni personalisht në zyrën tuaj të AMS-it.

Më shumë informacione mund të gjeni në: www.ams.at/arbeitslos-melden.

Për të përfituar nga shërbimet e AMS, duhet të përmbushen disa kushte.

Pas dorëzimit të kërkesës, do të verifikohet nëse keni të drejtë për përfitime financiare apo jo.

Aplikimi për oferta të punës



Ju do të merrni rregullisht oferta pune nga AMS:

- **Aplikoni sa më shpejt që të jetë e mundur.**
- Na informoni neve – brenda 8 ditësh – përmes telefonit ose MeinAMS mbi statusin e aplikimit tuaj.
- Na informoni nëse një ofertë pune nuk është e përshtatshme për ju.

Këshilla për dokumentet e aplikimit tuaj mund t'i gjeni në: www.ams.at/bewerbung.

Kërkimi aktiv i punës









Kërkoni edhe vetë në mënyrë aktive një vend pune përmes:

- Platformave në internet, aplikacioneve për punë si psh. **alle jobs** që është motor më i madh kërkimi për punë në Austri ose përmes **alle jobs App**
- Gazeta, revista profesionale
- Rrjetet personale (familja, miqtë, ish-kolegët)
- Kanale të mediave sociale të kompanive

Edhe nëse një kompani nuk ka shpallur vende të lira pune, ia vlen të dërgoni një aplikim.

Dokumentoni aplikimet tuaja në llogarinë MeinAMS ose mbani një listë dhe paraqitni atë te këshilltari apo këshilltarja juaj.

<p>Mbështetje në kërkimin e punës</p>	 	<ul style="list-style-type: none"> ➔ alle jobs: Motor kërkimi për punë nga AMS. Ai kontrollon të gjitha vendet e lira të punës që janë të regjistruara në AMS dhe në internet. Me një klikim, mund të gjeni të gjitha vendet e lira të punës në të gjithë Austrinë. ➔ eJob-Room: Këtu mund të krijoni një profil personal aplikimi dhe të kontaktoheni nga kompanitë. Përdorni funksione të ndryshme që do t'ju ndihmojnë në kërkimin e një vendi pune dhe lehtësojnë menaxhimin e dokumenteve tuaja të aplikimit. ➔ alle jobs App: Të gjitha ofertat e punës në Austri direkt në telefonin ose tabletin tuaj. Në zyrat tona, ka kompjuterë në dispozicionin tuaj për të kërkuar vende pune ose për të shkruar aplikime.
<p>Detyrimet e raportimit</p>		<p>Informoni AMS-in menjëherë për çdo ndryshim rreth gjendjes suaj personale, për shembull:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fillimin e një pune, edhe nëse është punësim me orarë të pjesshëm • Një ofertë pune që nuk u realizua • Sëmundje • Ndryshime në rrethanat personale (ndryshimi i adresës, qëndrimi jashtë vendit, lindja e një fëmije, periudha e kujdesit për fëmijët, aplikimi për pension) • Ndryshime në të ardhurat tuaja
<p>T'i përmbaheni marrëveshjeve</p>		<ul style="list-style-type: none"> ➔ Respektoni takimet dhe afatet! Nëse për arsye të rëndësishme nuk mund të merrni pjesë në një takim, ju lutemi na informoni me kohë. ➔ Qëndroni të arritshëm gjatë ditëve të punës: Regjistroni një numër telefoni dhe adresë e-mail të vlefshme në AMS dhe kontrolloni rregullisht llogarinë tuaj MeinAMS, e-mailet dhe postën tuaj. ➔ Zbatoni përmbajtjen e Marrëveshjes së Mbikëqyrjes dhe na dërgoni dokumente si CV, shpalljen e vendit të punës, etj. ➔ Merrni pjesë në trajnimet dhe kurset e dakorduara.
<p>MeinAMS</p>		<p>MeinAMS është lidhja juaj personale me AMS përmes internetit me këshilltaren apo këshilltarin tuaj. Përmes kesaj, ju mund të kryeni shumë gjëra online:</p> <ul style="list-style-type: none"> + Te aplikoni për ndihmë papunësie ose ndihmë emergjente + Te ndryshoni të dhënat personale + Te shikoni ofertat e punës + Te ruani aplikimet tuaja personale + Te regjistroheni dhe çregjistroheni nga AMS-i.
<p>Ndonjëherë mjafton edhe një telefonatë</p>		<p>Këshilltarët me përvojë të AMS-it ju ofrojnë shpejt informacione kompetente rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> + Regjistrimeve dhe çregjistrimeve për ndërprerje të shkurtra + Ndryshimeve në të dhënat personale + Caktimit të takimeve + Kthimit të përgjigjeve për ofertat e punës + Lëshimit të konfirmimeve të pagesave + Pyetjeve mbi pagesat, të ardhurat shtesë dhe llogarinë MeinAMS <p>Numrin e telefonit të shërbimit të AMS-it për rajonin tuaj mund ta gjeni në faqen tonë të internetit.</p>

Më shumë informacione mund të gjeni në www.ams.at ose në platformën tonë virtuale <https://360.ams.at/> dhe në zyrën tuaj të AMS.

Ju urojmë shumë sukses në kërkimin tuaj për punë!